



Bazuar në nenin 25 të Statutit të Komunës së Deçanit, nenet 5 dhe 17 pika (f) dhe (p) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, mbështetur në Rregulloren nr. 02/2013 Mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Ligjit Nr. 04 /L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2014, nxjerrë këtë:

VENDIM

Mbi Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale

I

Me këtë vendim themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena sh. a" e organizuar si Shoqëri Aksionare sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123.

II

Themelues i Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena sh. a" është Komuna e Deçanit si aksionare me 100% të kapitalit themeltar.

III

Komuna e Deçanit, nëpërmes Komisionit Komunal të Aksionarëve, do të ushtroi të drejtat e saj të aksionarit.

IV

Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena sh. a" është Rruga e UÇK-së pa nr.

V

Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës

01.Nr.VI-7

Deçan, dt.26.09.2014

KRYESE GRUPTA REKURSE	
REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DECAN MUNICIPALITY	
Ngj: RK-Deçan	No Prot: 22367
Ud: RK-Deçan	No. Prot: 22367
From: RK-Deçan	Prot. No: 22367
No. I dërguar: 04	Date: 30-09-14
Dr. Shërbimi: 04	Date: 30-09-14
No. I dërguar: 04	Date: 30-09-14
DECAN, DECANI	



Kryesuesi i Kuvendit

Jashar Dobraj